REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

# NJOFTIM PËR KËSHILLIM PUBLIK

## "MBI DHËNIEN E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE NË BREZIN 2100 MHZ (1920–1935 MHZ TË ÇIFTUAR ME 2110–2125 MHZ)"

**NËNTOR 2026**

Dokument për Këshillim Publik

*Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, nr. 31, datë 06.11.2026*

## I. HYRJE

Në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Radiokomunikimeve të ITU-së, brezat e çiftuar të frekuencave 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz (në vijim, "brezi i frekuencave 2100 MHz") mund të përdoren në nivel global për implementimin e telekomunikacioneve të lëvizshme ndërkombëtare (International Mobile Telecommunications-IMT).

Rregullorja Ndërkombëtare e Radiokomunikimeve e ITU-së përcakton brezin e frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz (2.1 GHz), në Rajonin 1, ku përfshihen edhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, për shërbimet fikse dhe mobile, mbi bazën e statusit primar të barabartë. Brezi i frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz mund të përdoret për IMT, në përputhje me shënimin 5.388 të Rregullores së Radiokomunikimeve: *5.388 Brezi i frekuencave 1 885–2 025 MHz dhe brezi 2 110–2 200 MHz janë të destinuar për përdorim, në nivel global, nga administratat që dëshirojnë të zbatojnë Telekomunikacionet e Lëvizshme Ndërkombëtare (IMT)**.** Ky përdorim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave nga shërbime të tjera, të cilave u janë alokuar këto breza. Këto breza frekuencash duhet të vihen në dispozicion për IMT në përputhje me Rezolutën 212 (Rev.WRC-15)* (shih gjithashtu Rezolutën 223 (Rev.WRC-15)***).** (WRC-15)*

Në Evropë, brezi 2100 MHz është harmonizuar fillimisht për implementimin e rrjeteve të bazuara në teknologjinë UMTS/IMT-2000, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së të miratuar në vitin 1999, të ashtuquajturin "Vendimi UMTS". Ky kuadër përfshinte brezat 1900–1980 MHz, 2010–2025 MHz dhe 2110–2170 MHz, duke parashikuar përdorimin FDD të brezave të çiftuar 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz, si dhe përdorimin TDD të brezave të paçiftuar 1900–1920 MHz dhe 2010–2025 MHz.

Me zhvillimin e teknologjive dhe rritjen e kërkesës për shërbime të komunikimeve elektronike me brez të gjerë pa tel, kuadri rregullator evropian u përshtat në përputhje me parimin e neutralitetit teknologjik. Në këtë kuadër, u miratua Vendimi i Komisionit 2012/688/BE[1], i cili harmonizoi brezin 1920–1980/2110–2170 MHz për rrjetet e komunikimeve mobile dhe fikse (MFCN) që operojnë në modalitetin FDD. Më tej, Vendimi i Komisionit 2020/667/BE[2], i cili ndryshoi Vendimin 2012/688/BE, lejoi përdorimin e sistemeve të antenave aktive (AAS) për sistemet 5G në këtë brez.

Sipas vendimit ECC/DEC/(06)01[3], brezi i frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz mund të përdoret për rrjetet e komunikimeve mobile dhe fikse (MFCN), të afta për të ofruar shërbime komunikimi me brez të gjerë pa tel. Vendimi ECC/DEC/(06)01 përcakton kushtet teknike të harmonizuara për përdorimin e brezit të frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz për MFCN, distancat e rekomanduara ndërmjet kanaleve dhe kufijtë e emetimeve, me qëllim garantimin e bashkëjetesës së shërbimeve të ndryshme radio. Ky brez frekuencash mund të përdoret gjithashtu për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve mobile në avionë (MCA) dhe në bordet

[1] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012D0688
[2] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32020D0667
[3] https://docdb.cept.org/download/4646

e anijeve (MCV), në përputhje me përcaktimet e vendimeve ECC/DEC/(06)07[4] dhe ECC/DEC/(08)08[5].

Dokumentet e tjera përkatëse të CEPT/ECC lidhur me përdorimin e brezit të frekuencave 2100 MHz për MFCN janë:

- Rekomandimi ERC/REC/01-01[6], i cili përcakton kërkesat për koordinimin e sistemeve MFCN që operojnë në brezat e frekuencave 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz;
- CEPT Report 39[7], i hartuar për Komisionin Evropian, i cili përmban rezultatet e studimeve teknike mbi përdorimin neutral ndaj teknologjisë të brezit të frekuencave 2100 MHz, duke përfshirë përdorimin FDD në brezat 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz, si dhe përdorimin TDD në brezat 1900–1920 MHz dhe 2010–2025 MHz.

Në përputhje me dokumentin e tij me titull "*Rapid access to spectrum for wireless electronic communications services through more flexibility*", i cili trajton, ndër të tjera, brezin tokësor 2100 MHz, Komisioni nxiti përdorimin më fleksibël të spektrit radio dhe forcoi parimet e neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve, nëpërmjet Direktivës 2002/21/KE[8] të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 mars 2002. Më 15 qershor 2009, Komisioni i dha një mandat CEPT-it për të përcaktuar, në kuadër të Politikës për Aksesin Wireless për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike (WAPECS), kushtet teknike që mundësojnë përdorimin sa më pak kufizues edhe të brezave të frekuencave 2 GHz.

Shqipëria ka zbatuar kuadrin evropian lidhur me përdorimin e brezit 1920–1980/2110–2170 MHz për qëllime MFCN. Ky brez u alokua për herë të parë në Shqipëri në vitin 2010, për një periudhë 15-vjeçare, për ofrimin e shërbimeve UMTS (3G). Në vitin 2015, AKEP miratoi heqjen e kufizimeve teknologjike, duke u dhënë sipërmarrësve të drejtën për përdorimin e brezit 2100 MHz pa kufizim teknologjik.

Bazuar në Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF) në fuqi dhe në linjë me Rregulloren e Radiokomunikimeve (ITU), brezat e çiftuar të frekuencave 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz janë alokuar për shërbimet mobile, në bazë primare, sipas shënimit 5.388A.

Gjithashtu, në nën-brezin 2110–2120 MHz mund të operojnë aplikacione të shërbimit të kërkimit hapësinor, gjithashtu në bazë primare. Në përputhje me përdorimin e harmonizuar në nivel evropian, PKF përcakton se brezi i frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz mund të caktohet në bazë primare për sistemet tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike, të cilat operojnë në modalitetin FDD. Ndërkohë sistemet civile MCA dhe MCV mund të operojnë në brezin 1920–1980/2110–2170 MHz në kuadër të shërbimit mobile, mbi baza dytësore.

[4] https://docdb.cept.org/download/4203
[5] https://docdb.cept.org/download/3713
[6] https://docdb.cept.org/download/4984
[7] https://docdb.cept.org/download/57
[8] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32002L0021

## II. Gjendja aktuale e përdorimit të brezit 2100 MHz

Bazuar në analizën e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz rezulton se spektri aktualisht i autorizuar për operatorët Vodafone Albania sh.a. dhe One Albania sh.a. është i ndarë ndërmjet përdorimeve FDD dhe TDD, me afate të ndryshme vlefshmërie për pjesë të ndryshme të spektrit.

Të tabelën më poshtë paraqitet situata aktuale e përdorimit të brezit 2100 MHz për shërbimet e lëvizshme:

| Sipërmarrësi | Brezi i frekuencave, Uplink (MHz) | Brezi i frekuencave, Downlink (MHz) | Teknologjia | Sasia totale e spektrit (MHz) | Kohëzgjatja e Autorizimit |
|---|---|---|---|---|---|
| **Vodafone Albania sh.a.** | 1920-1950 | 2110– 2140 | FDD | 15 MHz i çiftuar | Për 5 MHz: 06.11.2029<br>Për 5 MHz: 01.04.2031<br>***Për 5 MHz: 30.10.2026*** |
| **One Albania sh.a.** | 1950-1980 | 2140-2170 | FDD | 30 MHz i çiftuar | ***Për 10 MHz: 30.10.2026***<br>Për 15 MHz: 30.11.2027<br>Për 5 MHz: 01.04.2031 |
| | 1905 – 1915 | | TDD | 10 MHz i paçiftuar | ***Për 5 MHz: 30.10.2026***<br>Për 5 MHz: 30.11.2027 |


Për sipërmarrësin "Vodafone Albania" sh.a., e drejta e përdorimit të spektrit prej 2×5 MHz (FDD) ka përfunduar më datë 30.10.2026 dhe aktualisht po ndiqen procedurat përkatëse të rinovimit. Ndërkohë ka në përdorim edhe 10 MHz të ciftuar, nga të cilët 5 MHz (FDD) me afat vlefshmërie 06.11.2029 dhe 5 MHz (FDD) me afat vlefshmërie 01.04.2031.

Për sipërmarrësin "One Albania" sh.a., në pjesën FDD, e drejta e përdorimit për 10 MHz e çiftuar (2x10 MHz) ka përfunduar më 30.10.2026, dhe aktualisht po ndiqen procedurat përkatëse të rinovimit. Ndërkohë ka në përdorin 20 MHz të ciftuar, ku 15 MHz (FDD) me afat vlefshmërie 30.11.2027 dhe 5 MHz (FDD) me afat vlefshmërie 1.4.2031.

## III. Kushtet e përdorimit MFCN

Kushtet e përdorimit dhe kërkesat për menaxhimin e spektrit të frekuencave radio për sistemet tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike në brezin e frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz përcaktohen në kapitullin 4 të Planit të Përdorimit të Frekuencave.

Sasia prej 2×60 MHz e spektrit të disponueshëm në brezin e frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz është e ndarë në 24 njësi nga 5 MHz, duke formuar, me aplikimin e një distance dupleks prej 190 MHz**,** 12 njësi blloqesh dupleks frekuencash nga 5 MHz, sipas tabelës së mëposhtme:




Ndërkohë, kërkesa specifike për menaxhimin e spektrit të frekuencave, të cilat lidhen me aplikacione të caktuara, paraqiten në vijim. Konkretisht, për sistemet IoT përcaktohen kërkesa teknike lidhur me hapësirën nominale të kanalit dhe mënyrën e aplikimit të tyre në spektrin e frekuencave.

- *Kërkesat teknike për sistemet IoT* përcaktojnë se hapësira nominale e kanalit ndryshon në varësi të teknologjisë së përdorur.
- *Për sistemet UMTS*, parashikohet një hapësirë nominale kanali prej 5 MHz.
- Për sistemet *LTE, përfshirë LTE-MTC dhe LTE-eMTC,* hapësira nominale e kanalit mund të jetë 5 MHz, 10 MHz, 15 MHz ose 20 MHz.
- Për sistemet *NB-IoT*, specifikohet një hapësirë kanali prej 200 kHz, ndërsa për
- *NR (5G New Radio)* parashikohen hapësira nominale kanali prej 5 MHz, 10 MHz, 15 MHz ose 20 MHz.

Përveç përcaktimit të hapësirës nominale të kanalit, kërkesat teknike përcaktojnë edhe mënyrën e aplikimit të sistemeve IoT në spektrin e frekuencave. Kështu, sistemet LTE-MTC dhe LTE-eMTC operojnë në mënyrë in-band, pra brenda brezit të frekuencave të përdorur nga LTE. Ndërsa NB-IoT mund të implementohet në mënyrë in-band (IB-NB-IoT) ose në guard-band (GB-NB-IoT), në varësi të mënyrës së vendosjes së kanalit brenda strukturës së spektrit të LTE-së.

## IV. QËLLIMI I KONSULTIMIT PUBLIK

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në nenet 68 dhe 75 të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 13.12.2024, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave", si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 06.02.2026, "Për miratimin e rregullave për procedurën e konkurrimit publik për dhënien e autorizimeve individuale për të drejta të përdorimit të frekuencave", ndërmerr nismën për zhvillimin e konsultimit publik lidhur me dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)".

Kjo nismë ndërmerret gjithashtu në vijim të interesit paraprak të shprehur nga sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., për marrjen në përdorim të frekuencave në brezin 2100 MHz, të administruar pranë AKEP me shkresën nr. 1566 prot., datë 29.06.2026.

Brezi i frekuencave 2100 MHz përbën një burim të rëndësishëm për zhvillimin dhe zgjerimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve me brez të gjerë pa tel, rritjen e kapaciteteve të transmetimit të të dhënave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për përdoruesit fundorë. Ky brez, i harmonizuar në nivel evropian për përdorim nga sistemet e komunikimeve të lëvizshme, ofron mundësi për

shfrytëzimin e teknologjive të ndryshme, përfshirë LTE dhe 5G NR, në përputhje me kushtet teknike dhe rregullatore të zbatueshme.

Në kushtet e rritjes së vazhdueshme të kërkesës për shërbime të transmetimit të të dhënave, zgjerimit të përdorimit të aplikacioneve dhe shërbimeve digjitale, si dhe zhvillimit progresiv të rrjeteve të gjeneratës së pestë (5G), administrimi efektiv i spektrit të radiofrekuencave merr një rëndësi të veçantë për garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të komunikimeve elektronike.

Në këtë kontekst, AKEP vlerëson se dhënia në përdorim e frekuencave të disponueshme në brezin 2100 MHz mund të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të rrjeteve ekzistuese, përmirësimin e performancës së tyre, mbështetjen e investimeve në teknologjitë e reja, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike.

Objekt i këtij konsultimi publik është vlerësimi i interesit të tregut dhe i kushteve për dhënien e të drejtave të përdorimit të një sasie spektri prej 2×15 MHz në brezin 2100 MHz, në modalitetin FDD, konkretisht në blloqet e frekuencave 1920–1935 MHz, të çiftuara me 2110–2125 MHz.

Nëpërmjet këtij konsultimi publik, AKEP synon ndër të tjera:

- Nxitjen e përdorimit efektiv dhe eficient të spektrit të radiofrekuencave, duke krijuar mundësi për shfrytëzimin optimal të burimeve të disponueshme, në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet teknologjike.
- Identifikimin dhe vlerësimin e interesit të sipërmarrësve për marrjen në përdorim të frekuencave në brezin 2100 MHz, si dhe evidentimin e kërkesës së mundshme për sasinë e spektrit që propozohet të jepet në përdorim.
- Mbështetjen e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjeteve 4G dhe 5G, nëpërmjet krijimit të mundësive për rritjen e kapaciteteve të rrjeteve ekzistuese, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përballimin e kërkesës në rritje për transmetimin e të dhënave.
- Marrjen e opinioneve mbi kushtet teknike dhe rregullatore të autorizimit, duke përfshirë sasinë e spektrit që mund të caktohet, kohëzgjatjen e të drejtave të përdorimit, detyrimet që mund të shoqërojnë autorizimin, si dhe kushtet për përdorimin efektiv të frekuencave.
- Vlerësimin e nivelit të përshtatshëm të çmimit për dhënien e të drejtave të përdorimit, duke marrë në konsideratë karakteristikat e brezit, kushtet e tregut shqiptar, vlerën ekonomike të spektrit si dhe përvojat përkatëse ndërkombëtare.

AKEP synon që procesi i dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz të zhvillohet në përputhje me parimet e objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të sipërmarrësve, duke garantuar administrimin e përgjegjshëm të një burimi publik të kufizuar, siç është spektri i radiofrekuencave.

Në kuadër të këtij procesi, AKEP do të marrë në shqyrtim komentet, sugjerimet dhe propozimet e paraqitura nga sipërmarrësit dhe palët e tjera të interesuara, me qëllim vlerësimin e tyre

përpara përcaktimit të kushteve përfundimtare dhe zhvillimit të procedurës përkatëse të konkurrimit publik.

Në përfundim, AKEP synon që dhënia në përdorim e spektrit në brezin 2100 MHz të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike, përshpejtimin e transformimit digjital, përmirësimin e cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve, si dhe në rritjen e përfitimeve për konsumatorët, bizneset dhe ekonominë shqiptare.

## V. ÇËSHTJET E PARAQITURA PËR KONSULTIM PUBLIK

### I. Sasia e spektrit dhe struktura e së drejtës së përdorimit

Bazuar në ndarjen e spektrit të paraqitur më sipër, si dhe në karakteristikat teknike të sistemeve që mund të përdoren në brezin 2100 MHz, AKEP propozon dhënien e 1 (një) të drejte përdorimi për një sasi spektri prej 2×15 MHz (FDD).

**Pyetja 1:** A jeni dakord me propozimin e AKEP për dhënien e një të drejte të vetme përdorimi për sasinë prej 2×15 MHz në brezin 2100 MHz?

Lutemi të paraqisni mendimin tuaj, të shoqëruar me argumentet përkatëse teknike, ekonomike dhe rregullatore.

### II. Procedura e konkurrimit publik

Për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz, AKEP propozon zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik nëpërmjet procedurës së hapur, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, përfshirë VKM nr. 70, datë 06.02.2026, “Për miratimin e rregullave për procedurën e konkurrimit publik për dhënien e autorizimeve individuale për të drejta të përdorimit të frekuencave”.

**Pyetja 2:** A e konsideroni procedurën e hapur si formën më të përshtatshme për zhvillimin e konkurrimit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz?

Lutemi të paraqisni mendimin tuaj dhe, sipas rastit, propozime alternative të argumentuara.

### III. Vlerësimi ekonomik i së drejtës së përdorimit

Në kuadër të përcaktimit të vlerës ekonomike të së drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz, AKEP synon të marrë mendimet e palëve të interesuara mbi nivelin e çmimit dhe faktorët që duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit ekonomik të spektrit.

**Pyetja 3.1:** Cila është vlera ekonomike që do të ishit të gatshëm të paguanit për të drejtën e përdorimit të një sasie spektri prej 2×15 MHz në brezin 2100 MHz?

**Pyetja 3.2:** Cilët faktorë konsideroni se duhet të merren në konsideratë nga AKEP për përcaktimin e vlerës ekonomike të kësaj të drejte përdorimi?

Lutemi që, nëse është e mundur, të paraqisni një vlerësim konkret të vlerës ekonomike të spektrit prej 2×15 MHz, të shoqëruar me metodologjinë dhe argumentet mbështetëse.

## IV. Mundësia e zhvillimit të një procedure konkurruese për disa breza frekuencash (Multiband)

Duke marrë në konsideratë disponueshmërinë e spektrit prej 2×10 MHz (FDD) në brezin 800 MHz për ofrimin e shërbimeve të Telekomunikacioneve të Lëvizshme Ndërkombëtare (IMT), si dhe mundësinë e zhvillimit të një procedure të përbashkët konkurrimi për brezat 800 MHz dhe 2100 MHz, AKEP kërkon mendimin e palëve të interesuara për çështjet e mëposhtme.

**Pyetja 4.1:** A do të ishit të interesuar të merrnit pjesë në një procedurë konkurrimi publik që përfshin njëkohësisht brezat 800 MHz dhe 2100 MHz?

Në rast përgjigjeje pozitive, lutemi të specifikoni sasinë e spektrit në brezin 800 MHz për të cilën do të ishit të interesuar të aplikonit.

**Pyetja 4.2:** Në rast të përfitimit të së drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz, për cilat qëllime kryesore do ta shfrytëzonit këtë spektër?

Lutemi të specifikoni nëse përdorimi do të synonte zgjerimin e mbulimit gjeografik, përmirësimin e mbulimit brenda ndërtesave (indoor), mbulimin e zonave rurale, rritjen e kapacitetit të rrjetit apo qëllime të tjera.

**Pyetja 4.3:** Si e vlerësoni rëndësinë teknike dhe ekonomike të spektrit në brezin 800 MHz, krahasuar me spektrin në brezin 2100 MHz, për zhvillimin e rrjetit tuaj?

Lutemi të identifikoni faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë vlerësim.

**Pyetja 4.4:** A konsideroni se përfitimi i së drejtës së përdorimit në njërin prej këtyre brezave duhet të kushtëzohet me përfitimin e së drejtës së përdorimit në brezin tjetër?

Në rast përgjigjeje pozitive, lutemi të argumentoni arsyet teknike dhe ekonomike.

**Pyetja 4.5:** Cila është vlera që do të ishit të gatshëm të paguanit për të drejtën e përdorimit të një sasie spektri prej 2×5 MHz në brezin 800 MHz, nëse kjo e drejtë do të ofrohej në të njëjtën procedurë konkurrimi me brezin 2100 MHz?

Gjithashtu, lutemi të sqaroni nëse disponueshmëria e spektrit në brezin 800 MHz do të ndikonte në vlerën që do të ishit të gatshëm të paguanit për spektrin në brezin 2100 MHz.

**Pyetja 4.6:** Në rast të zhvillimit të një procedure konkurrimi për disa breza frekuencash, cilën strukturë të ofrimit të spektrit konsideroni më të përshtatshme?

Lutemi të shprehni mendimin tuaj mbi mundësinë e ofrimit të spektrit:

- Në lote të veçanta dhe të pavarura për secilin brez;
- Në lote të veçanta, me mundësi kombinimi nga i njëjti pjesëmarrës;
- Në një strukturë tjetër të propozuar prej jush.

Lutemi të argumentoni propozimin tuaj.

## V. Detyrimet për mbulimin me shërbime të komunikimeve elektronike

Duke marrë në konsideratë faktin se brezi 2100 MHz është përdorur nga operatorët për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme në Republikën e Shqipërisë që prej vitit 2010, si dhe zhvillimet teknologjike që mundësojnë përdorimin e tij për rrjetet 4G dhe 5G, AKEP kërkon mendimin e palëve të interesuara mbi përcaktimin e detyrimeve për mbulim në autorizimin individual.

**Pyetja 5:** A konsideroni se autorizimi individual për përdorimin e frekuencave në brezin 2100 MHz duhet të përfshijë detyrime specifike për mbulimin me sinjal dhe shërbime të komunikimeve elektronike?

Lutemi të shprehni mendimin tuaj lidhur me mbulimin e popullsisë, territorit, rrugëve kombëtare dhe zonave të tjera me rëndësi ekonomike apo shoqërore.

Në rast përgjigjeje pozitive, lutemi të propozoni objektiva konkrete të mbulimit dhe afatet përkatëse të realizimit, të shoqëruara me argumentet teknike dhe ekonomike.

## VI. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit individual

Kohëzgjatja e së drejtës së përdorimit të frekuencave përbën një element të rëndësishëm për planifikimin e investimeve, zhvillimin e infrastrukturës dhe garantimin e përdorimit efektiv të spektrit në periudhë afatgjatë.

**Pyetja 6:** Cila konsideroni se duhet të jetë kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në brezin 2100 MHz?

Lutemi të argumentoni propozimin tuaj.

## VII. Mënyra e pagesës për të drejtën e përdorimit të frekuencave

VKM nr. 70, datë 06.02.2026, “Për miratimin e rregullave për procedurën e konkurrimit publik për dhënien e autorizimeve individuale për të drejta të përdorimit të frekuencave”, parashikon përfshirjen e mënyrës së pagesës së autorizimit individual në dokumentacionin e tenderit.

**Pyetja 7:** Cilën mënyrë pagese konsideroni më të përshtatshme për shlyerjen e vlerës së së drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz?

- Pagesën e plotë në fillim të periudhës së autorizimit;
- Pagesën me këste, sipas një kalendari të përcaktuar.

Në rast se propozoni pagesën me këste, lutemi të specifikoni numrin e kësteve, periodicitetin dhe kalendarin e pagesave, duke respektuar afatin maksimal prej 1 (një) viti për shlyerjen e plotë të vlerës, si dhe të paraqisni argumentet mbështetëse.

## VIII. Teknologjia dhe mënyra e shfrytëzimit të spektrit

Në përputhje me parimin e neutralitetit teknologjik dhe kushtet teknike të zbatueshme për brezin 2100 MHz, AKEP synon të vlerësojë mënyrën e parashikuar të përdorimit të spektrit nga sipërmarrësit e interesuar.

**Pyetja 8:** Cilat teknologji dhe arkitektura rrjeti parashikoni të përdorni për shfrytëzimin e frekuencave në brezin 2100 MHz?

Lutemi të specifikoni nëse spektri do të përdoret kryesisht për:

- Rritjen e kapacitetit të rrjeteve ekzistuese;
- Zgjerimin dhe përmirësimin e mbulimit;
- Zhvillimin e rrjeteve 4G dhe 5G;
- Implementimin e teknologjive të tjera IMT;
- Qëllime të tjera të lidhura me zhvillimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Gjithashtu, lutemi të evidentoni faktorët kryesorë teknikë dhe ekonomikë që ndikojnë në përzgjedhjen e teknologjisë dhe mënyrën e shfrytëzimit të spektrit.

## IX. Çështje të tjera dhe propozime shtesë

**Pyetja 9:** A keni komente, sugjerime apo propozime të tjera që konsideroni të nevojshme të merren në konsideratë nga AKEP në kuadër të përgatitjes dhe zhvillimit të procedurës së konkurrimit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 2100 MHz?